



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-068

Prishtinë, më 15 qershor 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 15 QERSHOR 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu, Bilall Sherifi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Emrush Haxhiu, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga Zyra e Presidentit, Amir Haradinaj dhe
Nga OSBE-ja, Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë, të cilën e miratoi Kryesia.

Para fillimit të procedimit me pikat e rendit të ditës, me propozim të kryetarit, Kryesia e Kuvendit mbajti një minutë heshtje në shenjë nderimi për vdekjen e kryetarit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, zotit Dino Asanaj.

Gjithashtu, Kryesia pasi e shqyrtoi kërkesën për mbajtjen e mbledhjes komemorative të Kuvendit, me rastin e vdekjes së kryetarit të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, vendosi që Kuvendi të mbajë mbledhje komemorative për zotin Dino Asanaj, më 15 qershor 2012, në orën 12:00.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 4 dhe 8 qershor 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 4 dhe 8 qershor 2012

Procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 4 dhe 8 qershor 2012, u miratuan pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e Kuvendit të mbahet të premten, më 22 qershor 2012, me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektkodit të procedurës penale,
6. Shqyrtimi i vendimit të Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës për rishqyrtim,
7. Shqyrtimi i raportit të punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor, për vitin 2011.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

3.1. Kërkesa e deputetit Agim Kuleta për debat parlamentar në lidhje me përdorimin e tri (3) kodeve të huaja telefonike në Kosovë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkesa e deputetit Agim Kuleta për debat parlamentar në lidhje me përdorimin e tri (3) kodeve të huaja telefonike në Kosovë, në bazë të nenit 15.8 të Rregullores së Kuvendit, do të radhitet në rendin e ditës të mbledhjes plenare të Kuvendit brenda tri javësh pune, nga dita kur është marrë kjo shkallë e mbështetjes, për të cilën çështje vendos Kuvendi.

2. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht nga Ministria e Infrastrukturës që ta përgatisë informatën në lidhje me çështjen e përdorimit të tri (3) kodeve të huaja telefonike në Kosovë dhe Kuvendit t'ia paraqesin këtë informatë në afatin më të shkurtër të mundshëm.

3.2. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Mal të Zi

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i deputetëve të Kuvendit, në këtë përbërje: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Sasha Milosavljeviq dhe Blerta Deliu-Kodra, si dhe zyrtarët nga stafi mbështetës i Komisionit, Ahtere Loxha dhe Safet Beqiri, që të marrin pjesë në takimin punues ndërparlamentar, me temën “Roli i Parlamentit në procesin e negociatave të pranimit në BE”, që do të mbahet në Mal të Zi, prej 20-22 qershor 2012.

2. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës, me mundësi të rimbursimit nga Parlamenti Evropian, si dhe mëditjet shtesë për të lartpërmendurit në paragrafin një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

3.3. Paraqitja e aktiviteteve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikën e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që, para se të ftohet kryesuesi i Këshillit që të paraqitet në Kuvend, ta paraqet raportin për punën e Këshillit.

3.4. Njoftimi i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në lidhje me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri, prej 21 deri 22 maj 2012

Kryesia u njoftua me vizitën e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, të realizuar në Shqipëri, prej 21 deri më 22 maj 2012.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:25** minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale